



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 253/12 Prot.

Tiranë, më 30.06.2016

V E N D I M

Nr. 80, Datë 30.06.2016

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
UJËSJELLËS-KANALIZIME SHA TIRANË, MBI “ZBATIMIN E
LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKO - FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime SHA Tiranë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Auditimi i zbatimit të detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.

- **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna sipas raportit të mëparshëm të auditimit dërguar me shkresën nr. 325/14, datë 01.08.2014 drejtuar UKT sh.a, rezultoi se 25 masat organizative nuk janë realizuar dhe nga 8 masa shpërblim dëmi nuk janë realizuar 4 dhe 4 të tjera janë në proces (*trajtuar më hollësisht në faqet 18 deri 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara nga auditimi i mëparshëm.

Menjëherë

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorisë.

Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të auditimit lidhur me aktivitetin e Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2014, grupi të auditimit nuk ju vendos në dispozicion regjistri i pjesëmarrjes në mbledhje, i cili duhej nënshkruar nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të pranishëm, në çdo mbledhje. Në vendimet e marra nga Këshilli Mbikëqyrës në disa raste nuk është përcaktuar baza ligjore të cilës i referohet dhe bazohet vendimmarrja (*trajtuar më hollësisht në faqet 31 deri 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës të marri masa për mbajtjen dhe dokumentimin e saktë të procesverbaleve të mbledhjeve dhe të vendimeve, të përcaktojë bazën ligjore të cilës i referohet dhe bazohet vendimmarrja, si dhe në të gjitha relacionet mbështetëse të përcaktohet referenca ligjore.

Në vazhdimësi

3. Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar, detajimi i treguesve për prodhimin, shitjen e ujit në konsumatorët privat dhe popullatën, si dhe humbjet në rrjet, shpenzimeve dhe investimeve.

Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i treguesve ekonomiko-financiar për vitin 2014 rezultoi se, faturimi i ujit ka pësuar një ulje me vlerë 400 mijë m³, po ashtu edhe të ardhurat nga uji i faturuar kanë pësuar zbritje me vlerë 110 milionë lekë. Të ardhurat nga arkëtimi i ujit të faturuar kanë ardhur në rënie me vlerë 2 milionë lekë, krahasuar me parashikimin.

Investimet janë realizuar me vlerë 760 milionë lekë, nga parashikimi me vlerë 845 milionë lekë, me diferencë 85 milionë lekë. Mos realizimi i investimeve sipas programimit ndikon në përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të shpërndarjes, rritjen e numrit të klientëve dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të popullatës.

Shpenzimet janë realizuar me vlerë 242.9 milionë lekë, nga 329.5 milionë lekë të parashikuara. Nuk janë realizuar kryesisht shpenzimet për materiale të para, furnitura, si dhe shpenzime personeli. Të ardhurat nga faturimi i ujit, të cilat përbëjnë zërin kryesor të performancës së shoqërisë janë realizuar më pak nga parashikimi.

Realizimi i fitimit në vitin ushtrimor ka ardhur kryesisht nga zvogëlimi i investimeve dhe shpenzimeve dhe jo nga rritja e të ardhurave.

Sa i takon vitit 2015, rezulton se, ka një rritje të prodhimit të ujit në masën 1,266 mijë m³, ose 1.2 %, por ka një ulje të faturimit në sasinë 4,962 mijë m³, ose 5.9 %, pra janë ulur të ardhurat nga uji i faturuar në masën 93.6 milionë lekë ose 3.6 %.

Prodhimi i energjisë elektrike është rritur në masën 152 mijë kilovat, ose 1 %, ndërkohë që janë ulur arkëtimet në 116 milionë lekë, ose 4.8 %.

Investimet janë rritur nga parashikimi me vlerë 47.28 milionë lekë, ose 6.4 %, këto kryesisht në zërin ndërtim montim.

Sa i takon të ardhurave, ato rezultojnë me rënie në vlerën 93.6 milionë lekë, ose në masën 3.6 %. Edhe shitjet e ujit nga HEC Lanabregas janë me mos realizim me vlerë 6.68 milionë lekë ose me mos realizim në masën 5.5 %.

Në total të ardhurat janë realizuar me vlerë 3,022 milionë lekë, me diferencë nga parashikimi me vlerë 43.59 milionë lekë ose në masën 98.56 %.

Shpenzimet e parashikuara për vitin 2015 nuk janë realizuar sipas planifikimit, me një diferencë 63.55 milionë lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 34 deri 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

- UKT sh.a të marrë masa për realizimin e investimeve në masën e parashikuar, për marrjen e përfitimeve nga to dhe përmirësimin e situatës financiare të Shoqërisë. Të merren masa dhe të parashikohen me rritje investimet për rikonstruksionin e linjave shpërndarëse, për uljen e humbjeve teknike si dhe për eliminimin e lidhjeve të paligjshme duke i formalizuar ato, me synim rritjen e faturimeve dhe arkëtimeve të ujit të prodhuar.

- Të merren masa për pajisjen me sahate matës klientët ekzistues si dhe klientët e rinj, me synim uljen e numrit të klientëve që faturohen afrofe, të cilët mund të konsumojnë ujin e pijshëm pa kriter.

- Të merren masa për rritjen e faturimit të ujit të prodhuar si dhe rritjen e arkëtimeve nga faturimi, duke marrë në konsideratë faktin se, gjatë dy viteve të fundit nuk ka përmirësim në këtë drejtim.

Në vazhdimësi

4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve dhe zbatimin e strukturës organizative.

4.1.Gjetje nga auditimi: Struktura organizative e UKT sha për periudhën objekt auditimi ka pësuar disa herë ndryshime duke krijuar probleme në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit normal të shoqërisë. Me vendimin nr. 25 datë 09.12.2015 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionereve, “Për Ristrukturimin dhe Miratimin e Strukturës Organizative dhe Numrit Të Përgjithshëm të Punonjësve Të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sha.” është vendosur struktura organizative dhe miratimi i numrit të përgjithshëm të punonjësve të UKT sha, prej 864 punonjësish. Ky ristrukturim është kërkuar dhe i është propozuar Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve, nga ish-Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë z. [REDAKTUAR] me shkresën nr. 23675/2 datë 26.11.2015, pa një analizë tekniko-financiare për çdo sektorë apo njësi të UKT sha mbi bazën e të cilës ato të pasqyronin nevojat e tyre apo të evidentonin problemet funksionale. Si pasojë e kësaj nuk ka patur një evidentim të saktë dhe objektiv në lidhje me sektorët apo vendet e punës të cilat duhet të suprimoheshin apo t’ju shkërtojë fuqia punëtore. Në relacionin drejtuar Asamblesë përmendet se këto ndryshime strukturore janë rekomanduar në raportin vlerësues për situatën tekniko-ekonomike të UKT sh.a që ka realizuar shoqëria “[REDAKTUAR]”, një shoqëri kjo e cila në bazë të të dhënave të sektorit të koordinimit të projekteve të huaja pranë UKT sha, nuk ka kryer auditim të mirëfilltë për shoqërinë por vetëm takime interaktive midis ekspertëve të saj dhe stafit të UKT sh.a si pasojë e të cilave ka dalë me një preventiv mbi

kostot e një auditimi të mundshëm që do të mund të kryej prej saj. Pra, nga ana e kësaj shoqërie nuk rezulton të jetë bërë auditim dhe për pasojë nuk janë dhënë rekomandime lidhur me strukturën organizative të UKT sh.a, siç pretendon ish- Drejtori i Përgjithshëm në relacionin drejtuar Asamblesë së Aksionerëve.

Sipas analizës së trajtuar nga ish-Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë në relacionin drejtuar Asamblesë rezulton se struktura organizative e shoqërisë veçanërisht ajo e aparatit të administratës është e mbingarkuar me burime njerëzore dhe në shumë sektorë vendet e punës janë të dubluar, ndërkohë në ndryshimet strukturore të cilat i janë propozuar Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve konstatohet se ndryshimet në lidhje me administratën faktikisht konsistojnë në ndryshime emërtimesh të departamenteve ekzistuese, krijimi i drejtorisë task-forcë, ndërsa ndryshimet në njësitë zonale konsistojnë në uljen e numrit të faturuesve, uljen e numrit të hidraulikëve, shoferëve, teknikëve të ndryshëm si pompist, klorinues, saldator, mekanik, teknik bilanci, inxhinier matje, etj. Ndryshimet e strukturës organizative, duke ulur numrin e stafit teknik dhe specialistëve të fushave të ndryshme, pa një analizë të mirëfilltë tekniko/financiare bien ndesh me objektin e veprimtarisë së vetë shoqërisë duke mos garantuar cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorit në terma të përgjithshëm. ***Veprimet e mësipërme të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë bien ndesh me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 14 pika 1, neni 98 pika a, c, dh, dhe rregullores së brendshme të shoqërisë pika 2.2.1.***

Si pasojë e zbatimit të Vendimit nr. 25 datë 09.12.2015 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve dhe Urdhrit të Brendshëm nr. 636 datë 10.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm z. [REDAKTUAR], gjatë muajit Dhjetor 2015 janë nxjerrë vendimet për zgjidhjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkurtimeve të pozicionit të punës dhe suprimim i vendit të punës për 339 punonjës, 6 vendime për ndryshim pozicioni pune dhe 10 zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënieve të punës për shkaqe të justifikuara, shumica në datë 30.12.2015. Këto vendime kanë sjellë hapjen e procedurave gjyqësore nga punonjësit e larguar si dhe nga ata të cilëve ju është ndryshuar pozicioni i punës. Nga informacioni që ju vendos në dispozicion grupit të auditimit nga Drejtoria Juridike pranë UKT sha, rezulton se aktualisht shoqëria është në proces gjyqësor në 210 raste, nga të cilat 162 janë hapur si pasojë e këtij rristrukturimi (trajtuar më hollësisht në faqet 38 deri 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë :

- UKT sh.a, në raste të tilla rristrukturimi masiv dhe ndërhyrjes në strukturat organike të shoqërisë duhet të bazohet detyrimisht në një analizë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të veprimtarisë dhe performancës së saj institucionale, duke shmangur në çdo rast marrjen e vendimeve të nxituara dhe të pabazuara për largimin masiv dhe arbitrar të punonjësve të këtij institucioni, ç’ ka do të shmangte në të ardhmen jo vetëm pasojat sociale të këtyre vendimeve por, edhe kostot financiare që mund t’i shtoheshin shoqërisë si pasojë e humbjeve të proceseve gjyqësore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4.2.Gjetje nga auditimi: Në rregulloren e brendshme të institucionit të UKT sh.a përgjithësisht për të gjitha pozicionet e punës, nuk është përcaktuar lloji i arsimimit apo kualifikimet përkatëse. Nuk janë të parashtruara në asnjë rast nevojat e degëve për zëvendësim apo rekrutim të ri. Edhe në drejtim të kriterëve për rekrutimin e stafit të ri nuk ekzistojnë procedura të përcaktuara, si psh, intervista, testim, etj, si dhe nuk janë të përcaktuar edhe kriteret për çdo pozicion pune, niveli arsimor përkatës dhe eksperiencia në punë. Për sa më sipër, ***Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë UKT sh.a, paraqet një risk***

të lartë jo vetëm në lidhje me zbatimin e vendimit nr 636 datë 10.12.2015 të ish-Drejtorit të Përgjithshëm për ristrukturimin por edhe në lidhje me rekrutimin e punonjësve të rinj.

-Niveli i pagave për periudhën objekt auditimi është përcaktuar me vendimin nr. 14 datë 23.12.2013 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë “ Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Punës dhe Strukturës Organizative të Shoqërisë”, duke ju përmbajtur tabelës së miratuar me vendimin nr. 19 datë 21.12.2010 të Këshillit Mbikëqyrës “Për miratimin e tabelave të pagave dhe të kualifikimit të punonjësve të UKT sh.a”, e cila i ka përcaktuar klasat sipas pozicioneve të punës por pa qartësuar kualifikimin e punonjësve për klasifikimin respektiv.

-Dosjet e personelit nuk janë plotësuar në të gjitha rastet në mënyrë korrekte dhe zyrtare bazuar në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Vendimit me nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe kontratës kolektive të shoqërisë. Kontratat e punës jo në të gjitha rastet janë të firmosura në çdo faqe nga punëmarrësi dhe një kopje e saj nuk ndodhet në sektorin e protokoll-arkivës, gjithashtu nga auditimi u konstatua se punonjësit nuk janë të pajisur me një kopje të kontratës së tyre të punës (trajtuar më hollësisht në faqet 38 deri 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masat e duhura që në raste rekrutimesh të reja përparësi t’u jepet punonjësve të cilët janë larguar si pasojë e ristrukturimit (pushimit kolektiv nga puna).

- Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a/Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa për plotësimin e dosjeve personale të punonjësve me të gjithë dokumentacionin e duhur. Të gjithë punonjësit të pajisen me një kopje kontrate individuale të punës dhe një kopje të arkivohet pranë zyrës së protokoll-arkivës.

- Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa të rishikojnë rregulloren e brendshme të institucionit duke përfshirë në të procedura vlerësimesh vjetore për punonjësit, gjithashtu të përshkruhen qartë procedurat në lidhje me rekrutimin duke vendosur kritere në bazë të profesionalizmit në punësimin e stafit duke rritur transparencën dhe trajtimin e barabartë midis punonjësve.

- Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrin masa të rishikojnë strukturën për përcaktimin e llojit të arsimimit për pozicionet e punës të cilat nuk i kanë të përcaktuara dhe për çdo pozicion pune të bëhet përshkrimi i punës në mënyrë që çdo i punësuar të ketë detyra të qarta dhe të mire përcaktuara.

- Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a të marrin masat e duhura dhe konkrete për plotësimin e klasave dhe niveleve të pagave me kritere dhe specifikime të qarta dhe në funksion të kësaj të bëhet përcaktimi i pagave sipas pozicionit për çdo punonjës.

Menjëherë

5. Rregullariteti dhe ligjshmëria në evidentimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve.

5.1. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me pagesat e kryera nëpërmjet arkës rezultoi se Administratori nuk ka përcaktuar limitin e arkës, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 63, ku përcaktohet: “Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës, të miratuar nga Nëpunësi i Parë Autorizues me propozim të Sistemit të Thesarit, me akte të veçanta sipas njësive publike” (trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Referuar pagesave të kryera nëpërmjet arkës u konstatua se janë kryer në 80 raste në vlerë 1,150,936 lekë për blerje materiale të ndryshme dhe për shërbime brenda vendit, paradhënie etj., për vitin 2014, dhe në 56 raste në vlerën 1,601,390 lekë për blerje materiale të ndryshme dhe për shërbime brenda vendit, paradhënie etj., për vitin 2015, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 63, (trajtuar më hollësisht në faqet 115 deri 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga titullari i shoqërisë UKT sh.a, të përcaktohet limiti i veprimeve nëpërmjet arkës, në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, gjithashtu të merren masa për kryerjen e veprimeve nëpërmjet arkës në përputhje me ligjet, udhëzimet dhe aktet në fuqi.

Menjëherë

5.2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i pagesave të bëra nëpërmjet arkës dhe bankës për blerjet e vogla, rezultoi se janë kryer pagesa duke mos plotësuar praktikën e gjithë dokumentacionit justifikues, si ofertat e marra nga operatorët ekonomik (minimalisht 3 oferta), fletë hyrjen në magazinë, aktin e marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, urdhri i prokurimit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga ana e shoqërisë të merren masat e duhura për plotësimin e gjithë dokumentacionit mbi praktikën e shpenzimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të prokurimit rast për rast për procedurat e prokurimit publik për blerjet e vogla në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe të ligjeve, udhëzimeve, akteve ligjore e nënligjore në fuqi, etj.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i veprimeve të kryera me zgjedhje, nëpërmjet bankës në lekë rezultoi se, janë kryer pagesat për gjoba e penalitete të vendosura, të cilat kanë ardhur kryesisht nga vonesat në pagesat e detyrimeve tatimore sipas viteve 2009-2015, në shumën 19,753,843 lekë, pa nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për veprime apo mos veprime, të stafit të UKT (trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe drejtuesit e shoqërisë UKT sh.a, veprimet e tyre të analizohen shkaqet e marrjes së këtyre gjobave dhe penaliteteve, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe personat përgjegjës për sjelljen e tyre pasi këto pasoja kanë rënduar buxhetin e shoqërisë në shumën 19,753,843 lekë.

Në vazhdimësi

5.4. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, shpenzimeve për goma, servise etj., rezultoi se nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve, dhe Drejtoria e Transportit dhe Oficinës nuk është evidentuar kilometrazhi i automjeteve në fillim dhe në fund të vitit për të bërë të mundur ndjekjen e shpenzimeve periodike të automjeteve *(trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për këtë rekomandojmë:

1-Nga Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve, Drejtoria e Transportit dhe Oficinës, të merren masat dhe të bëhet hapja e kartelave personale të çdo automjeti, gjithashtu të bëhet evidentimi i saktë i kilometrazhit të automjeteve për të monitoruar dhe ndjekur të gjitha shpenzimet e automjeteve duke organizuar dhe koordinuar punën, duke rritur kërkesën e llogarisë mbi shpenzimet e karburantit si dhe shpenzimeve të tjera të automjeteve për goma, servis etj., në fillim dhe në fund të vitit duke bërë rakordimet përkatëse.

2-Nga audit i brëndshëm i shoqërisë, të përfshijë me prioritet në planet e auditiveve, çështje që kanë të bëjnë me shpenzimet për karburant, goma, servise etj., për përmirësimin e mëtejshëm të mbajtjes së dokumentacionit si dhe të monitorojë mënyrën e mbajtjes së tyre.

Menjëherë dhe në vazhdim

5.5 Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlera të vogla u konstatua se në disa raste nuk është ngritur apo krijuar komision për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar, duke vepruar në kundërshtim Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, pikat 42, 43, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara” *(trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Titullari i i shoqërisë UKT sh.a., të krijohet urdhër i veçantë për marrjen në dorëzim të mallrave e shërbimeve të prokuruar, në zbatim Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, pikat 42-50.

Menjëherë dhe në vazhdim

6. Evidentimi, planifikimi dhe realizimi i të ardhurave të realizuara nga shitja e ujit dhe nga shërbimet e tjera.

Gjetje nga auditimi:

Rregullorja brendshme e shoqërisë e miratuar me vendimin e Asamblesë së Aksionarëve me nr. 14, datë 23.12.2013 nuk ka të përcaktuar procedurë që ndiqet për konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundërvajtjes administrative. Konkretisht: llojet e kundërvajtës administrative, masa e gjobës respektive, akt konstatimi, hartimi i procesverbaleve, vendosja e gjobave, regjistrimi i gjobave, zyrat ku depozitohet gjoba, gjobat me shpërbllim dëmi, procedura për arkëtimin e gjobës etj, si dhe nuk ka rregullore të veçantë konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundërvajtës administrative *(trajtuar më hollësisht në faqet 40 deri 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Për këtë rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës të rishikohet rregullorja e miratuar, dhe të vendoset një procedurë e mirëfilltë në lidhje me konstatimin, dokumentimin dhe ekzekutimin e kundërvajtjeve administrative për gjobat e vendosura.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Mbajtja e evidencës kontabile, nxjerrja dhe miratimi i bilancit në organet drejtuese të shoqërisë dhe te vartësisë institucionale.

Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me mbajtjen e pasqyrave financiare u konstatua se kishte diferenca në paraqitjen e të dhënave të këtyre pasqyrave pasi u vërejtën mospërputhje të llogarive të bilancit të mbyllur në 31.12.2014, me llogaritë e çeljeve të vitit 2015, të pashoqëruara nga shënimet shpjeguese në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Standartet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar (SNRF) (trajtuar më hollësisht në faqet 56 deri 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Të bëhen sistemit e veprimeve dhe të dhënave të sakta të llogarive të bilancit të çeljes për vitin 2015, në përputhje me (SNRF) dhe (SNK).

Menjëherë

8. Inventarizimi i pasurisë dhe zbatimi i procedurave ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre.

Gjetje nga auditimi:

Mbi auditimin e inventarëve të mbajtura nga UKT sh.a, konstatohen parregullsi në vlerat e pasqyruara përsa i përket mallrave rikupero dhe atyre stok. Nuk është vazhduar procedura për asgjësimin e tyre sipas urdhrave përkatës. UKT sh.a, për vitet 2014 dhe 2015, nuk ka asgjësuar materialet e nxjerra jashtë përdorimit.

-Nuk është bërë një analizë e mallrave stok për të parë nëse ka mallra që i nevojiten UKT sh.a duke shmangur në këtë mënyrë kryerjen e procedurave të reja të prokurimit me objekt mallra që mund të jenë tek mallrat stok. Për mallrat stok që kapin një vlerë të konsiderueshme, UKT sh.a nuk ka marrë asnjë masë për menaxhimin e tyre ose dërgimin e tyre tek njësi të tjera për administrim.

-Për mallrat që janë deklaruar të vjedhura ose për ato që nuk janë nën përgjegjësinë e personave të autorizuar, UKT sh.a, nuk ka marrë asnjë masë për nxjerrjen e përgjegjësive ose shkaqeve të humbjes së tyre por as nuk ka ndarë përgjegjësitë tek personat përkatës (trajtuar më hollësisht në faqet 66 deri 78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- UKT sh.a, Drejtoria e Financës, të marrin masat për të kryer inventarizimin e aseteve në mënyrë korrekte duke pasqyruar të gjitha të dhënat e aseteve dhe specifikimet teknike të pajisjeve së bashku me vendndodhjen e tyre të saktë.

- UKT sh.a, të marri masa për ndjekjen me korrektësi të procedurave të asgjësimit të materialeve të vlerësuara si aktive jashtë përdorimit.

- UKT sh.a, të marri masa që mallrat të cilat janë vlerësuar si mallra stok, të vlerësohen dhe të përdoren ose nga UKT sh.a ose nga njësitë e tjera operative me qëllim që të shmangët kryerja e procedurave të pa nevojshme të prokurimit për mallra ose pajisje që mund të jenë në gjendje të mirë tek mallrat stok.

- UKT sh.a, të marri masa për të nxjerr përgjegjësitë ndaj personave me përgjegjësi materiale në rastet që ato janë dëmtuar ose vjedhur.

Vazhdimisht

9. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike. Lidhja e zbatimi i kontratave për ndërtime, rikonstruksione, pajisje e makineri, (investime), mallra dhe shërbime.

9.1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit ***“Blerje Autobot për UKT sh.a” viti 2014***, u konstatua se janë blerë tre autobote nga të cilët dy janë blerë dhe përdorur për transportin e ujit të pijshëm dhe një është blerë për transportin e lëndëve djegëse (karburant) por në fakt ky i fundit është përdorur për transportin e ujit të pijshëm. Si rrjedhojë, autoboti me targa AA 063 KA, me numër leje qarkullimi TRDB7386714, i llojit ATV, i markës Volvo, i tipit E4C, i emërimit tregtar FL6, me numër shasje YV2E4CAA81B291796, është një autobot i cili është blerë dhe kolauduar nga UKT sh.a për të transportuar në depozitën (Cisternën) e tij karburant për nevojat e UKT sh.a dhe jo ujë siç në fakt ka transportuar referuar fletëve të udhëtimit që janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe që pasqyrojnë periudhën 05/09/2015 deri 31/12/2015. Fakti që kontrolli teknik i kryer për matjen e vëllimit të depozitës, është kryer duke përdorur karburant (sipas certifikatës së kontrollit të vëllimit dhe presionit përkatës të matur), tregon se ky autobot, duhej të përdorej vetëm për transportin e lëndëve të rrezikshme dhe jo për furnizime me ujë aq më tepër që cisterna me nr. 682 e vendosur mbi mjetin me targa AA 063 KA, është mbushur me karburant gjatë procesit të matjes së vëllimit dhe lëshimit të pasaportës nga operatori ekonomik “**[REDAKTUAR]**” sh.p.k (të dhënat janë marrë nga pasaporta dhe certifikata e mjetit).

Certifikatat e lëshuara nga operatori ekonomik “**[REDAKTUAR]**” sh.p.k, kanë skaduar më 26.12.2015 dhe UKT sh.a, ***vazhdon të përdori autobotet e ujit por dhe atë të naftës, pa certifikatë të kontrollit teknik dhe vëllimit, duke vënë në rrezik jetën e banorëve.***

UKT sh.a, ka përdorur për transportin e ujit të pijshëm, një mjet i cili ka një depozitë (cisternë) e cila është blerë për transport të lëndëve djegëse por mbi të gjitha është kolauduar me lëndë djegëse dhe nuk plotëson kushtet higjeno-sanitare konform direktivës nr. 98/83/KE, datë 03.11.1998. Referuar kësaj direktive dhe konkretisht tek Annex II, part 1, specifikohen qartazi kushtet e transportit të ujit me autobote (Tanker). Tek e njëjta direktivë, citohen dhe afatet kohore të inspektimit të cisternave që përdoren për transportin e ujit për të cilat UKT sh.a, nuk disponon asnjë dokumentacion për respektimin e këtyre afateve që varen nga frekuenca e përdorimit (furnizimit me ujë pasqyruar tek tabelat e direktivës) (*trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a, Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a, Drejtoria e Transportit dhe Oficinës, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Drejtoria e Drejtorisë së Transportit-Oficinës, konform Kreut 7, nenit 7.2, nenit 7.6 , nenit 7.6.1 të rregullores së brendshme të UKT sh.a, të marrin masat që në të ardhmen, të përdorin për transportin e ujit vetëm ata autobotë të cilët plotësojnë të gjitha standardet e direktivës nr. 98/83/KE, datë 03.11.1998 por mbi të gjitha, të respektojnë afatet e kolaudimit të cisternave duke garantuar se cisternat plotësojnë kushtet higjeno-sanitare për furnizimin e publikut me ujë.

Në vazhdimësi

9.2. Gjetje nga auditimi:

Gjatë zbatimit të kontratës ***“Blerje elektropompa për UKT sh.a” viti 2014 dhe 2015***, me shkresën nr. 2501/1, datë 10.06.2014 dhe nr. 2296/1, datë 08.05.2015, drejtori i departamentit inxhinierik i UKT sh.a, **[REDAKTUAR]**, ka dërguar kërkesën për fillimin e procedurës së prokurimit ku citohet: ***“Nisur nga parashikimet e bëra në plan buxhetin e***

vitit 2014/2015 për repartin elektromekanik kërkohet blerja e elektropompave sipas tabelës më poshtë”. Kërkesa është e pa argumentuar teknikisht dhe nuk ka të bashkangjitur asnjë relacion mbi historikun e defekteve. Kjo shkresë, nuk duhet vetëm të përmendte se është parashikuar kjo procedurë por dhe të argumentonte nevojën e blerjes së elektropompave (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- UKT sh.a, Drejtoria e Prokurimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të argumentojnë nevojën e kryerjes së procedurave të prokurimit duke dokumentuar më parë arsyet për fillimin e procedurave, duke kontrolluar gjendjen faktike të magazinës për mallrat që do të prokurohen (nëse ka apo jo) dhe qëllimin e kryerjes së procedurave ose destinacionin e mallit.

- UKT sh.a, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masat që në të ardhmen të mbajnë librat përkatës të historikut të defekteve të ndodhura tek pajisjet që diponojnë me qëllim shmangien e kryerjes së procedurave të pa nevojshme të prokurimit por dhe nxjerrjen e përgjegjësive në rastet kur nuk është kryer mirëmbajtja e tyre.

Në vazhdimësi

9.3. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Blerje matësa uji për UKT sh.a” viti 2015*”, u konstatua se në faqen e APP-së, UKT sh.a ka ngarkuar në sistem dokumentet standarde të tenderit për herë të parë më 09.12.2015 me numër reference 18776. Kjo procedurë e nisur në këtë datë, ka vazhduar deri tek “Njoftimi i kontratës” më 10.12.2015, ora 10:36. Sipas të dhënave nga faqja e APP-së, pas këtij momenti, KVO, nuk ka kryer asnjë veprim për vazhdimin e procedurës. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk u konstatua asnjë dokumentacion i mbajtur për këtë procedurë. Pra, njësia e prokurimit, nuk disponon asnjë dokumentacion rreth zhvillimit të kësaj procedure përsa i përket datës dhe orës së caktuar por as dokumentacion ku të pasqyroheshin hapat e ndjekur deri tek njoftimi i kontratës apo arsyet e anulimit të procedurës me objekt “Blerje matësish uji për nevojat e UKT”. Kjo procedurë prokurimi, ka filluar përsëri në datën 10.12.2015, ora 15:23, me numër reference 19136, pra pak orë pasi është bërë njoftimi i kontratës së të njëjtës procedurë por me numër reference 18776 të filluar më 09.12.2015.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se është shpallur fitues operatori ekonomik “██████” sh.p.k me ofertën me vlerë 28,454,600 lekë i cili ka marrësi të theksuara në dokumentacionin e dorëzuar. Pasi KVO ka kryer kualifikimin e operatorit të mësipërm sipas procesverbalit me nr. 24623/7, datë 11.12.2015, kanë paraqitur ankesat dy operatorë të tjerë të skualifikuar të cilët pasi kanë marrë përgjigjet nga UKT sh.a se ankesa e tyre nuk është marrë parasysh, i janë drejtuar KPP-së për të bërë ankesën e tyre. Nga këta dy operatorë, njëri prej tyre, ka tërhequr ankesën e depozituar pranë KPP-së (sipas deklaratës së KPP-së) dhe si rrjedhojë KPP ka shqyrtuar ankesën e një operatori dhe konkretisht të operatorit ekonomik “██████” sh.a. Operatori ekonomik i skualifikuar nga KVO dhe që ka tërhequr ankesën nga KPP, është “██████” sh.p.k me ofertën me vlerë 27,272,727 lekë. Ky operator, ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga UKT sh.a por KVO e ka skualifikuar atë. Si rrjedhojë, nga ky skualifikim i pa drejtë, UKT sh.a, i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën e 1,181,273 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- UKT sh.a, Drejtoria e Prokurimit, të marrin masat që në të ardhmen, të dokumentojnë të gjithë hapat e ndjekur për zhvillimin e procedurave të prokurimit duke vepruar konform VKM nr. 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar, neni 57, njësia e prokurimit.
- UKT sh.a, Drejtori i Përgjithshëm i UKT sh.a, të marrin masat që në të ardhmen të veprojnë me profesionalizëm dhe logjikë ekonomike duke vlerësuar më parë ofertën më të ulët në interes të institucionit dhe për çdo mangësi apo devijim të vogël, të kërkojnë sqarime konform pikës 4 të nenit 53 të ligjit të prokurimit publik të ndryshuar nr. 9643, datë 20.11.2006.

Në vazhdimësi

9.4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dokumenteve standarde të tenderit për procedurën e prokurimit "**Blerje tuba dhe rakorderi për UKT sh.a" viti 2015**", u konstatua se tek specifikimet teknike dhe konkretisht tek shtojca 10, manikota, bërryla, bashkuese PE, kërkohet që të jenë të markës "Plasson". Ky kriter është i vendosur në kundërshtim me ligjin 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, për prokurimin publik, neni 23, pika 5 ku citohet "Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime" dhe ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar tek faqja e APP-së nga operatorët që kanë marrë pjesë në tender, u konstatua se është kualifikuar me mangësi në dokumentacion operatori ekonomik "██████" sh.p.k me ofertën me vlerë 6,333,000 lekë, dhe është skualifikuar pa mangësi (janë fare të papërfillshme mangësitë që përmenden) operatori ekonomik "██████" sh.p.k me ofertën me vlerë 5,599,500 lekë. Dëmi ekonomik i shkaktuar për UKT sh.a, është 733,500 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

- UKT sh.a, Drejtoria e Prokurimit, të marrin masat që në të ardhmen, të hartojnë specifikimet teknike pa përmendur markat apo emërtimet e mallrave që do të prokurohen duke vepruar konform ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, për prokurimin publik, neni 23, pika 5.
- UKT sh.a, Drejtori i Përgjithshëm, të marrin masat që në të ardhmen të veprojnë me profesionalizëm dhe logjikë ekonomike duke vlerësuar më parë ofertën më të ulët në interes të institucionit dhe për çdo mangësi të vogël, të kërkojnë sqarime konform pikës 4 të nenit 53 të ligjit të prokurimit publik të ndryshuar nr. 9643, datë 20.11.2006.

Në vazhdimësi

9.5. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me procedurën e prokurimit "**Blerje kimikate për UKT sh.a**", u konstatua se janë krijuar zvarritje të procedurave si pasojë e vendosjeve të kriterëve të cilat kanë sjellë këto pasoja, duke u kryer dy procedura me negociim pa shpallje, ku njëra prej tyre ka qenë e panevojshme, dhe zvarritja e procedurës ka ardhur për mangësi të vogla të cilat po të shiheshin në këndvështrim me objektivitet, nuk do të kishin sjellë vonesa në kryerjen e procedurës me objektin e mësipërm (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e shoqërisë, Drejtoria e Prokurimeve duke parë se blerja e kimikateve është një procedurë e domosdoshme e cila kryhet çdo vit, të merren masat për planifikim në

fillim të çdo viti për të mos sjellë pasoja të tilla duke përdorur fondet me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet.

Në vazhdimësi

10. Auditim me zgjedhje në ditarët e arkës dhe të bankës. Rregullshmëria e regjistrimit të dokumenteve në llogaritë përkatëse, rregullshmëria e dokumenteve justifikuese të shpenzimeve.

10.1. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me pagesat e kryera nëpërmjet bankës për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, u konstatuan në 35 raste për vitin 2014 dhe në 68 raste për vitin 2015, si dhe në 47 raste për vitin 2014 dhe në 54 raste për vitin 2015 marrja në dorëzim apo akti i kolauditimit është mbajtur vetëm nga 1 person, gjithashtu u konstatua se mungon urdhri i titullarit në lidhje me ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të tyre duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III, pikat 42 (trajtuar më hollësisht në faqet 115 deri 120 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Të merren masat nga titullari i UKT sh.a., ku në lidhje me furnizimin për mallra, punë e shërbime në të gjitha rastet të krijohet komisioni i marrjes në dorëzim të tyre në përputhje me bazën ligjore aktet nënligjore dhe udhëzimet në fuqi për to.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10.2. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi i bërë në magazinën Brar, rezultoi se në të gjitha rastet e regjistrimit të fletëhyrjeve në magazinë, u konstatua se ato regjistrohen vetëm në sasi dhe jo në vlerë, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III, pika 36 (trajtuar më hollësisht në faqet 115 deri 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Të merren masat nga shoqëria UKT sh.a, dhe sektorët përkatës ku për të gjitha dokumentet fletëhyrje dhe fletë dalje nga magazina të plotësohen sipas rubrikave përkatëse në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe të Auditit të Brendshëm.

Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezulton se nuk është hartuar deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Pyetësin e Vetëvlerësimit për periudhën objekt auditimi.

Në lidhje me hartimin e një plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar në datën 04.11.2013 është nxjerrë shkresa nr. 367/1 e Drejtorit të Përgjithshëm z. [] për menaxhimin e riskut në Shoqërinë UKT sh.a. Në lidhje me këtë nuk disponohet informacion për zbatimin e tij në vazhdimësi për periudhën e audituar. Sektori i riskut në UKT sh.a ka funksionuar dhe funksionon në varësi të Departamentit të Shitjes dhe fokusohet vetëm në riskun e vjeljes së debisë. Këto mangësi janë konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të kryer nga Kontrolli i Latë i Shtetit, por nuk janë marrë masat e

duhura për përmirësimin e punës në të ardhmen (trajtuar më hollësisht në faqet 120 deri 126 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat si dhe të hartojë plan-veprimet afat shkurtra për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Në kuadër të zbatueshmërisë së ligjit të organizohen trajnime dhe seminare për të gjithë stafin me qëllim implementimin dhe zbatimin sa më të mirë të këtij ligji në praktikë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

B. 1-MASA SHPËRBLIM DËMI

UKT sh.a të kontabilizojë dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **10,193,109.8 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i dosjes së tenderit me objekt **“Blerje kimikate për UKT sh.a”** për vitin 2015, me procedurë negociim pa shpallje u konstatua se me veprimet dhe mosveprimet e tyre titullari i Autoritetit Kontraktorë, Drejtori i Prokurimeve dhe Njësia e Prokurimit, nuk kanë bërë analizë të çmimeve të marra nga komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit si dhe nuk kanë bërë krahasime me kontratat e mëparshme të cilës t’i referoheshin për argumentimin fondit limit, duke shkaktuar një rritje fiktive të fondit limit në shumën prej 4,254,990 lekë me pasojë rëndimin e buxhetit të shoqërisë UKT sh.a, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, neni 59, **“Përllogaritja e vlerës së kontratës”**, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik”** të ndryshuar Kreun II, nenin 12, dhe në papajtueshmëri me Rregulloren e Brendshme të shoqërisë të miratuar me vendimin nr. 14 datë 23.12.2013, pika 7.5 dhe 7.5.1 (trajtuar më hollësisht në 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit **në vlerën 4,254,990 lekë** të shkaktuar buxhetit të shtetit nga përllogaritja e gabuar e vlerës së kontratës duke sjellë një rritje fiktive të fondit limit nga z. [REDAKTUAR] **me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm, znj. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Prokurimeve, znj. [REDAKTUAR], znj. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR]** në cilësinë e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit.

Menjëherë.

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit **“Blerje matës uji për UKT sh.a” viti 2015**, rezulton se është skualifikuar operatori ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k për mangësi të cilat nuk qëndrojnë. KVO nuk ka kërkuar sqarime dhe nuk ka shqyrtuar ankesat të cilat kanë qenë brenda afatit dhe përpara datës së kualifikimit të ofertuesve. Kualifikimi i operatorit ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k me mangësi të theksuara në dokumentacion, është kryer në kundërshtim me ligjin dhe kriteret e kualifikimit dhe mbi të gjitha, KVO duhet të përdorte të merrte në konsideratë kriterin ekonomik, me qëllim mbrojtjen e interesave të

institucionit (UKT sh.a) duke përzgjedhur ofertën më të ulët. Diferenca e ofertave është: $28,454,000 - 27,272,727 = 1,181,273$ lekë vlerë kjo e konsiderueshme për UKT sh.a.

-Sa më sipër, vlera prej 1,181,273 lekë, përbën dëm ekonomik për UKT sh.a dhe ngarkon me përgjegjësi drejtorin e UKT sh.a [REDACTED] i cili ka miratuar raportin përmbledhës së KVO-së duke shpallur fituesin dhe komisionin e vlerësimit të ofertave i përbërë nga [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] të cilët kanë bërë vlerësimin (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit **në vlerën 1,181,273 lekë** të shkaktuar Shoqërisë nga skualifikimi me të padrejtë dhe kualifikimi i operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion, nga z. [REDACTED], [REDACTED], znj. [REDACTED] dhe z. [REDACTED] në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi:

Në dosjen e procedurës së prokurimit “**Blerje automjete për vitin 2014**” ndodhet dokumentacioni mbi shtyrjen e afatit të kontratës. Kontraktori “[REDACTED]”, me shkresë nr. s’ka, datë 10.06.2014 (6 ditë para skadimit të afatit të kontratës) ka njoftuar Autoritetin kontraktor mbi pamundësinë e furnizimit të automjeteve në kohën e përcaktuar në kontratë, për shkaqe që nuk varen nga kjo kompani. Vonesa është justifikuar nga prodhuesi “[REDACTED]” S.r.l Itali të datës 09.07.2014, me tekst: “*Me anë të kësaj deklarate, duam t’ju kërkojmë ndjesë për vonesën e shkaktuar për dorëzimin e produkteve të porositura nga ju në bashkëpunim me [REDACTED] sh.p.k. Kjo vonesa është shkaktuar nga një problem i brendshëm në ndërmarrjen tonë, mungesë material, një problem të cilin e kemi zgjidhur dhe po punojmë ende në mënyrë që këto produkte t’ju dorëzohen sa më shpejt të jetë e mundur*”. Është kërkuar shtyrje afati deri me datë 26.07.2014.

Në Nenin 23, Pika 23.2 të kontratës përcaktohet: “**Për qëllimet e këtij neni *Forcë Madhore* do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme...**

Pavarësisht sa më sipër mungesa e materialit nuk është ngjarje e paparashikueshme dhe nuk mund të konsiderohet forcë madhore bazuar në kushtet e kontratës.

Bazuar në dokumentacionin e financës pranë UKT sh.a, në lidhje me datën e furnizimit të mjeteve, rezulton se automjetet janë dorëzuar me vonesë. Sipas përlogaritjeve Kontraktori duhet të penalizohet për dorëzim të vonuar me vlerë 1,331,064 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,331,064 lekë** nga Kontraktori “[REDACTED]” sh.p.k, si penalizim për dorëzim të vonuar të furnizimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “**Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën që kufizohet nga rrugët: “Idriz Dollaku”, Isuf Seferi”, Ismet Gusia” dhe “Tanush Topia”,** nga verifikimi i punimeve rezulton se ka diferenca të sasisë së përshkruar në situacionin përfundimtar krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 672,450 lekë, në kundërshtim

me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Neni 7. *Për këtë veprim mban përgjegjësi Mbikëqyrësi i Punimeve Shogëria “██████” Sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën 672,450 lekë nga Kontraktori (bashkimi i operatorëve ekonomikë) “██████” sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “**Ndërtim rrjet ujësjellësi në zonën ndërmjet rrugëve Pjetër Budi, Arben Broci dhe Dajti**”, rezulton se sipas ditarit punimet kanë përfunduar me datë 22.07.2015, ndërkohë që mbikëqyrësi i punimeve ka njoftuar përfundimin e punimeve me datë 14.07.2015. Me shkresë nr. M064/3 prot., datë 25.06.2015, mbikëqyrësi i punimeve ka kërkuar lirimin e sheshit për disa segmente, me argumentin se disa banorë kanë bllokuar punimet për arsye të ndryshme. Nga verifikimi i ditarit të punimeve rezulton se, në asnjë rast nuk është përshkruar ndonjë bllokim punimesh. Po ashtu nuk ka një miratim të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve nga UKT sh.a. Ky veprim bie në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit pika 14.

Në këto kushte, bazuar në nenin 36 të kontratës, Kontraktori duhet të penalizohet për përfundim me vonesë të punimeve për një afat 22 ditë, me vlerë 182,397 lekë.

Nga verifikimi i situacionit përfundimtar dhe librezës së masave rezulton se ka diferenca të punimeve me vlerë 342,732 lekë, e cila është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “██████”.

Nga auditimi në terren rezulton se ka diferenca të punimeve realizuar në fakt me ato të likuiduara me vlerë 143,304 lekë, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori “██████” dhe përbën dëm ekonomik. Në total, nga subjekti i mësipërm është përfituar padrejtësisht vlera 668,443 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimin e dëmit në vlerën 668,433 lekë nga Kontraktori (bashkimi i operatorëve ekonomikë) “██████” sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës “**Ndërtim rrjet furnizimi me ujë të depos 1000 m³ tek Liqeni i Thatë dhe rrjeti shpërndarës për zonën**”, rezulton se ka diferenca të punimeve të likuiduara krahasuar me ato të realizuara në fakt me vlerë 546,148.8 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Neni 7, përfituar padrejtësisht nga bashkimi i operatorëve “██████” Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

UKT sh.a të kryejë kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykitimit, për shpërblimin e dëmit në **vlerën 546,148.8 lekë** nga Kontraktori (bashkimi i operatorëve ekonomikë) “” sh.p.k, për punime të likuiduara, por të pa realizuara.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje tuba dhe rakorderi për UKT sh.a” viti 2015” bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë UKT sh.a dhe tek faqja e APP, rezulton se:

-Operatori ekonomik “” sh.p.k me ofertën me vlerë 6,333,000 lekë i cili është shpallur fitues, ka këto mangësi:

a) Vërtetimi i debisë ndaj OSHEE sh.a me nr. 1555, datë 10.12.2015, është në emrin e dhe jo në emër të operatorit ekonomik “” sh.p.k por mbi të gjitha midis operatorit ekonomik dhe personit, nuk ka asnjë kontratë qiraje të dorëzuar por as ndonjë adresë të cilësuar tek vërtetimi e cila do kishte lidhje me zonën e Fierit në të cilën është nxjerr dhe vërtetimi. Gjithsesi, edhe sikur të ekzistonte një kontratë qiraje midis dhe operatorit ekonomik “” sh.p.k, ajo do të ishte e pa vlefshme pasi tek ekstrakti i QKR, operatori ekonomik “” sh.p.k, ka hequr adresën Fier më 02.10.2015 pra shumë kohë përpara se të zhvillohej procedura e prokurimit.

b) Tek ekstrakti i QKR, operatori ekonomik “” sh.p.k, nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij, aktivitetet ose zëra që kanë lidhje me objektin që prokurohet. Konkretisht, tek objekti i veprimtarisë së tij, operatori ekonomik nuk ka tregti me shumicë ose pakicë të materialeve hidraulike si tuba ose rakorderi, etj.

-Operatori ekonomik “” sh.p.k me ofertën me vlerë 5,599,000 lekë i skualifikuar:

a) Operatori ekonomik “” sh.p.k., ka dorëzuar bilancet e kërkuara të cilat janë të konfirmuara nga drejtoria e tatimeve. Mangësia e cilësuar nga KVO se mungon certifikimi nga një ekspert i pavarur, është shmangie e vogël dhe nuk ndryshon asgjë tek bilancet e dorëzuara ose më saktë nuk garanton vërtetësinë e tyre pasi një gjë e tillë është garantuar nga drejtoria e tatimeve.

b) Operatori ekonomik “” sh.p.k, ka dorëzuar autorizimin nga prodhuesi.

c) Operatori ekonomik i skualifikuar, ka paraqitur dhe kontratë për punime hidraulike tek e cila ka shumë zëra mallrash të ngjashëm me objektin që prokurohet. Kjo kontratë e paraqitur, ka një vlerë shumë më të lartë se vlera e kërkuar nga UKT sh.a por mbi të gjitha, operatori ekonomik i skualifikuar, ka paraqitur një kontratë të lidhur midis tij dhe një distributori i cili do ta furnizojë me të gjitha materialet e nevojshme hidraulike që janë objekt i prokurimit.

-Si rrjedhojë, KVO, në rastin konkret, duhej të kërkonte sqarim nga operatori ekonomik dhe jo ta skualifikonte atë aq më tepër që bëhet fjalë për devijime shumë të vogla. KVO duhet të përdorë në këtë rast kriterin ekonomik, me qëllim mbrojtjen e interesave të institucionit (UKT) duke përzgjedhur ofertën më të ulët. Diferenca e ofertave është: $6,333,000 - 5,599,500 = 733,500$ lekë vlerë kjo e konsiderueshme për UKT sh.a.

-Sa më sipër, vlera prej 733,500 lekë, përbën dëm ekonomik për UKT sh.a dhe ngarkon me përgjegjësi ish-drejtorin e UKT sh.a i cili ka miratuar raportin përmbledhës të KVO-së dhe ka shpallur fituesin dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga , dhe (trajtuar më hollësisht në faqet 74 deri 115 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjyimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 733,500 lekë, të shkaktuar Shoqërisë nga skualifikimi me të padrejtë dhe kualifikimi i operatorit ekonomik me mangësi në dokumentacion, nga z. [REDAKTUAR], znj. [REDAKTUAR], znj. [REDAKTUAR] dhe znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarëve të KVO.

8. Gjetje nga auditimi:

Në lidhje me shpenzimet e kryera për karburant për automjetet e shoqërisë për periudhën objekt auditimi u konstatua se nga përllogaritja e furnizimit me karburant për vitin 2015 rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr me kilometrat e përshkuara për disa automjete, dhe rezultoi se janë përfituar më tepër 1,442 litra në shumën 233,598 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë dhe duhet të kthehet nga përfituesit.

Nga përllogaritja e konsumit të karburantit u konstatua se janë marrë më tepër karburant në lidhje me kilometrat e përshkuara sipas tabelës me të dhënat më sipër dhe referuar çmimit mesatar për vitin 2014 të shpenzimeve për karburant u konstatua se janë është shpenzuar më tepër në vlerën 214,891 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë dhe duhet të kthehet nga përfituesit.

Gjithashtu nga përllogaritja e furnizimit me karburant për vitin 2014 rezultoi se nuk përputhej sasia e tërhequr me kilometrat e përshkuara për disa automjete, dhe rezultoi se janë përfituar më tepër 749 litra nga të cilat 396 litra benzinë * 169 lekë/litër = 66,914 lekë, dhe 353 litra naftë * 162 lekë/litër = 57,259 lekë dhe në total shuma prej 124,173 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë e cila duhet të kthehet nga përfituesit.

Nga përllogaritja e konsumit të karburantit u konstatua se janë marrë më tepër karburant në lidhje me kilometrat e përshkuara sipas tabelës me të dhënat më sipër dhe referuar çmimit mesatar për vitin 2014 të shpenzimeve për karburant u konstatua se janë është shpenzuar më tepër në vlerën 144,669 lekë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë dhe duhet të kthehet nga përfituesit. Pra në total shoqërisë UKT sh.a, për periudhën objekt auditimi nga shpenzimet e kryera për karburant për automjetet e saj, i është shkaktuar një dëm ekonomik në total prej 717,331 lekë, e cila është përdorur nga shoferët pa përcaktuar normativat përkatëse dhe pa u monitoruar saktë mbi konsumin e automjeteve të shoqërisë (trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Nga UKT sh.a, të analizohet sipas destinacionit dhe personit përfitues si dhe të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjyimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën 717,331 lekë të shkaktuar buxhetit të shtetit nga marrja më tepër e karburantit, nga shoferët sipas përdorimit të automjeteve për secilën periudhë.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi:

Sipas zërit udhëtime e djeta është vepruar në kundërshtim me Vendimin nr. 870, datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", duke likuiduar më tepër vlerën 225 Euro për trajtim financiar në 7 raste dhe vlerën 210 Euro për fjetje në hotel dhe bileta udhëtimi në 6 raste (trajtuar më hollësisht në faqet 115-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën **435 Euro** të shkaktuar buxhetit të shtetit nga përfitimi i padrejtë i shpenzimeve për udhëtime e dieta për 6 punonjësit:*

Znj. [REDAKTUAR] me vlerë 178.8 Euro; znj. [REDAKTUAR] 43.8 Euro; znj. [REDAKTUAR] 92.4 Euro; z. [REDAKTUAR] 56.2 Euro; z. [REDAKTUAR] 68.8 Euro; z. [REDAKTUAR] me vlerë 193 Euro.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi me zgjedhje mbi rregullshmërinë e kryerjes së Shpenzimeve për udhëtime dhe dieta u konstatua se është likuiduar z. [REDAKTUAR] për shërbime udhëtimi jashtë vendit, ka përfituar shërbime karburanti në shumën 548 Euro ndërkohë që për periudhën e udhëtimit ka kuponë për karburant vetëm për shumën prej 370 Euro, pra diferenca prej 178 Euro është përfituar më tepër e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të kthehet nga përfituesi. Gjithashtu është likuiduar për 5 ditë nga 40 Euro në shumën 200 Euro për dietë ndërkohë që shuma që duhet të përfitonte është 25 Euro në ditë, pra ka përfituar 15 euro në ditë më tepër gjithsej 75 Euro e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë pasi është vepruar në kundërshtim me Vendimin nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, në të cilin përcaktohet se shpërblimi i dietës është 25 Euro në ditë. **Në total shuma prej 193 Euro përbën dëm ekonomik për shoqërinë dhe duhet të kthehet nga përfituesi (trajtuar më hollësisht në faqet 115 deri 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Për këtë rekomandojmë:

*Nga UKT sh.a, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore të gjitha shkallët e gjykimit, për shpërblimit e dëmit në vlerën **193 Euro** nga punonjësi [REDAKTUAR].*

Menjëherë

B. 2-TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi:

Gjendja debitore në datën 31.12.2014 nga mos arkëtimi i faturave të Ujit të pijshëm është në masën 3,273,117,028.48 lekë. Gjendja debitore në datën 31.12.2015 nga mos arkëtimi i faturave të Ujit të pijshëm është në masën 3,864,373,169.97 lekë. Nga analiza e bërë rezulton se nga viti 2014 në vitin 2015 shuma e debitorëve është rritur me 591,256,141.49 lekë pra me rreth 17%, duke krijuar/shkaktuar të ardhura te munguara për shoqërinë për këto vlera debitore, vlera të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në performancën ekonomike të shoqërisë (trajtuar më hollësisht në faqet 50 deri 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

*Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e Shoqërisë UKT sh.a., të merren masat për analizimin e debitorëve të shkaqeve të rritjes së tyre, duke ngritur grupe të posaçme dhe duke përdorur strategjitë e duhura në minimizimin e këtyre shumave debitore, të cilat në fund të vitit 2014 rezultojnë në vlerën **3,273,117,028.48** lekë dhe në fund të vitit 2015 në vlerën **3,864,373,169.97** lekë, ku nga viti 2014 në vitin 2015 shuma e debitorëve është rritur me **591,256,141.49** lekë të ardhura te munguara për shoqërinë.*

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i kryer konstatohet se, për vitin 2014, nga sasia totale e ujit të prodhuar në sistem për 103,448,361 m³, nuk janë faturuar 70,727,679 m³, e cila e vlerësuar me çmim mesatar për njësi (për 88.77 lekë/m³), rezulton në shumën 6,278 milion lekë. Kjo është një e ardhur e munguar për shoqërinë, me ndikim drejtpërdrejtë në performacën e treguesve ekonomik e financiar për vitin 2014.

Për vitin 2015, nga sasia totale e ujit të prodhuar në sistem për 102.866.821 m³, nuk janë faturuar 68,689,352 m³, e cila e vlerësuar me çmim mesatar për njësi (për 86.16 lekë/m³), rezulton në shumën 5,918 milion lekë, e ardhur e munguar për shoqërinë, me ndikim drejtpërdrejtë në performacën e treguesve ekonomik e financiar për vitin 2015 (trajtuar më hollësisht në faqet 50 deri 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Asambleja e Aksionarëve, Këshilli Mbikëqyrës, dhe Strukturat Drejtuese të Shoqërisë UKT sh.a, të mblidhen dhe të analizojnë Departamentin e Shitjes në lidhje me problemet e prodhimit, faturimit, arkëtimit, dhe lidhjen e kontratave të reja, si synim për përmirësimin e këtyre treguesve si dhe realizimin e objektivave të shoqërisë, gjithashtu të ngrihen struktura efektive në lidhje me monitorimin periodik për ndjekjen e nivelit të prodhim-faturim dhe arkëtimit të ujit nga konsumatorët, pasi i janë sjellë shoqërisë të ardhura të munguara për vitin 2014, në vlerën 6,278 milion lekë dhe për vitin 2015 me vlerë 5,918 milion lekë me ndikim drejtpërdrejtë në performacën e treguesve ekonomik e financiar të UKT sh.a.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

B. 3-SHPENZIME DHE TË ARDHURA JO NË PËRPUTHJE ME PARIMET E EKONOMICITETIT, EFIÇENCËS DHE EFEKTIVITETIT

Për shpenzimet dhe të ardhurat të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në të ardhurat e shoqërisë, duke sjellë një rëndim të buxhetit të Shoqërisë, pasi në realizimin e shpenzimeve që shoqëria duhet të kryejë nuk është zbatuar parimi i 3E-ve, Ekonicitetit, Efektivitetit dhe Efiçencë.

1. Gjetje nga auditimi:

Janë kryer pagesa për gjoba dhe interesa për gjoba ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për detyrime tatimore të kryera me vonesë, të marra dhe të mbartura ndër vite me vlerë 19,753,843 lekë, pa u analizuar nga bordi drejtues i shoqërisë dhe Këshilli Mbikëqyrës, duke mos nxjerrë përgjegjësitë për sjelljen e këtyre penaliteteve dhe gjobave ndaj shoqërisë, si dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për ngarkimin me përgjegjësi të personave personave përgjegjës, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në kundërshtim me Udhëzimin e MF Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 43 deri 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për këtë rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e UKT sh.a të marrë masa për ngritjen e një grupi pune të veçantë, për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonicitet dhe efiçensë të fondeve publike për pagesat e kryera në lidhje me gjobat e marra ndër vite në vlerën 19,753,843 lekë, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë.

D. MASA DISIPLINORE

Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kontratën Kolektive të punës Neni 24, kërkojmë nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

I. “Pushim nga puna” për:

1. znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish/drejtoreshës e Burimeve Njerëzore, aktualisht përgjegjëse sektori, për arsye se:

-Në zbatim të Vendimit nr .636 datë 10.12.2015 të ish/Drejtorit të Përgjithshëm z. [REDAKTUAR], ka bërë përzgjedhjen e punonjësve të cilëve ju janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës dhe suprimim i vendit të punës si dhe për ndryshim pozicioni pune pa vendosur dhe zbatuar kriteret për çdo pozicion pune, pa bërë një analizë të plotë gjithëpërfshirëse të veprimtarisë dhe performancës së institucionit, duke sjellë marrjen e vendimeve të nxituara dhe të pabazuara për largimin masiv të 339 punonjësve të këtij institucioni.

Këto vendime kanë sjellë hapjen e 162 proceseve gjyqësore nga punonjësit e larguar si dhe nga ata të cilëve ju është ndryshuar pozicioni i punës, ç’ ka do t’i shtonte kosto financiare shoqërisë si pasojë e humbjeve të proceseve gjyqësore.

-nuk ka evidentuar në asnjë rast nevojat e degëve për zëvendësim apo rekrutim të ri;

-nuk ka hartuar procedura të qarta lidhur me marrjen në punë të punonjësve, si psh, intervista, testim, etj, siç nuk ka përcaktuar edhe kriteret për çdo pozicion pune, niveli arsimor përkatës dhe eksperiencia në punë;

- dosjet e personelit nuk janë hartuar në të gjitha rastet në mënyrë korrekte dhe zyrtare bazuar në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, vendimit nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe kontratës kolektive të shoqërisë;

-kontratat e punës jo në të gjitha rastet janë të firmosura në çdo faqe nga punëmarrësi dhe një kopje e saj nuk ndodhet në sektorin e protokoll-arshivës, gjithashtu nga auditimi u konstatua se punonjësit nuk janë të pajisur me një kopje të kontratës së tyre të punës;

-Nga auditimi i dosjes së tenderit me objekt “*Blerje kimikate për UKT sh.a*”, nuk është bërë analizë të çmimeve të marra nga komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit si dhe nuk kanë bërë krahasime me kontratat e mëparshme të cilës t’i referoheshin për fondin limit, duke shkaktuar një rritje fiktive të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 59, “*Përllogaritja e vlerës së kontratës*”.

2. z. [REDAKTUAR],

3. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarëve të KVO-së për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje matës uji për UKT sh.a viti 2015”, pasi rezulton se ka skualifikuar operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k për mangësi të cilat nuk qëndrojnë duke shkaktuar për buxhetin e UKT-sh.a një dëm ekonomik në vlerën e 1,181,273 lekë.

4. zj. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtares së KVO-së

- Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje matës uji për UKT sh.a viti 2015”, pasi rezulton se ka skualifikuar operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k për mangësi të cilat nuk qëndrojnë duke shkaktuar për buxhetin e UKT-sh.a një dëm ekonomik në vlerën e 1,181,273 lekë.

- Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tuba dhe rakorderi për UKT sh.a viti 2015”, pasi rezulton se ka skualifikuar operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” sh.p.k për mangësi

të cilat nuk qëndrojnë duke shkaktuar për buxhetin e UKT sh.a një dëm ekonomik në vlerën e 733,500 lekë.

5. zj. [REDAKTUAR],

6. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarëve të KVO-së për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje tuba dhe rakorderi për UKT sh.a viti 2015”, pasi rezultoi se ka skualifikuar operatorin ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k për mangësi të cilat nuk qëndrojnë duke shkaktuar për buxhetin e UKT-sh.a një dëm ekonomik në vlerën e 733,500 lekë.

II. “Vërejtje me shkrim” deri në “Pushim nga puna” për:

1. znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e përgjegjëses së burimeve njerëzore, për arsye se:

- nuk ka evidentuar në asnjë rast nevojat e degëve për zëvendësim apo rekrutim të ri;
- nuk ka hartuar procedura të qarta lidhur me marrjen në punë të punonjësve, si psh, intervista, testim, etj, siç nuk ka përcaktuar edhe kriteret për çdo pozicion pune, niveli arsimor përkatës dhe eksperiencia në punë;
- dosjet e personelit nuk janë hartuar në të gjitha rastet në mënyrë korrekte dhe zyrtare bazuar në Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, vendimit nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe kontratës kolektive të shoqërisë;
- kontratat e punës jo në të gjitha rastet janë të firmosura në çdo faqe nga punëmarrësi dhe një kopje e saj nuk ndodhet në sektorin e protokoll-arshivës, gjithashtu nga auditimi u konstatua se punonjësit nuk janë të pajisur me një kopje të kontratës së tyre të punës;

2. znj. [REDAKTUAR]

3. znj. [REDAKTUAR]

4. znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, sepse:

Nga auditimi i dosjes së tenderit me objekt “Blerje kimikate për UKT sh.a”, me veprimet dhe mosveprimet e tyre titullari i AK, Drejtore e Prokurimeve dhe NJP, nuk kanë bërë analizë të çmimeve të marra nga komisioni i ngritur për përllogaritjen e fondit limit si dhe nuk kanë bërë krahasime me kontratat e mëparshme të cilës t’i referoheshin për fondin limit, duke shkaktuar një rritje fiktive të fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 59, “Përllogaritja e vlerës së kontratës”.

Është kryer një procedurë me negociim pa shpallje me objekt “Blerje kimikate për UKT në”, në një kohë që nuk ishte e domosdoshme të kryhej pasi:

Kjo procedurë bie ndesh me kryerjen e saj dhe vendimmarrjen e UKT-së pasi është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu I, neni 1, “Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor”, me LPP nr. 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu II, nenin 20 “Mosdiskriminimi”, me nenin 33, “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, pika 2, germa c), duke qenë e panevojshme të kryhej.

Znj. [REDAKTUAR] edhe gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje tuba dhe rekorderi për vitin 2015”, ka skualifikuar një operator ekonomik megjithëse mangësitë konsiderohen shmangie të vogla si dhe operatori i shpallur fitues ka mangësi të theksuara të dokumentacionit të paraqitur, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 733,500 lekë.

5. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Drejtorit të Departamentit Inxhinierik të UKT, sepse:

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje elektropompa për UKT sh.a viti 2014 dhe 2015”, kërkesën e fillimit të procedurës së prokurimit, mbi nevojën e blerjes së elektropompave, e ka të pa argumentuar teknikisht dhe nuk ka të bashkangjitur asnjë relacion mbi historikun e defekteve. Kjo kërkesë, nuk duhet vetëm të përmendte se është

parashikuar kjo procedurë por dhe të argumentonte nevojën e blerjes së elektropompave.

6. zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, sepse:

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje matës uji për UKT sh.a viti 2015”, me numër reference 18776, e anuluar, nuk ka mbajtur dokumentacionin ligjor në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, e ndryshuar, neni 57.

7. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO, sepse:

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje automjete për vitin 2014” ka kualifikuar një operator ekonomik pa paraqitur dokumentacionin e plotë dhe nuk është kërkuar sqarime, në kundërshtim me dokumentet e tenderit.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin e Auditimit janë konstatuar përgjegjësi të natyrës administrative, të cilat mund të vlerësoheshin me masën disiplinore si më poshtë:

“Largim nga detyra”, për [REDAKTUAR], në cilësinë e ish Drejtorit të Përgjithshëm të UKT.

“Vërejtje me shkrim” deri **“Pushim nga puna”** për:

1. znj. [REDAKTUAR] në cilësinë e Drejtores së Departamentit Ekonomik
2. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve
3. [REDAKTUAR] në cilësinë e Drejtorit të Transportit dhe Oficinës
4. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e Përgjegjës të Oficinës
5. z. [REDAKTUAR] në cilësinë e anëtarit të KVO
6. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e anëtarit të KVO
7. znj. [REDAKTUAR], në cilësinë anëtarit të Njësisë së Prokurimit
8. znj. [REDAKTUAR], në cilësinë anëtarit të Njësisë së Prokurimit
9. znj. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-sekretares së Këshillit Mbikëqyrës.
10. znj. [REDAKTUAR] me detyrë ish/drejtores e Departamentit Ekonomik
11. znj. [REDAKTUAR] me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit të Raportimit Financiar.
12. z. [REDAKTUAR], në cilësinë e Ish-Drejtorit të Përgjithshëm të UKT.

Meqenëse personat e mësipërm janë larguar nga puna, masat disiplinore konsiderohen të ezauruara.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R